

UDHËZIM
Nr. 4, datë 9.1.2017

**PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE STANDARDEVE MINIMALE QË DUHET
TË PLOTËSOJNË PIKAT SEKONDARE TË BASTEVE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të pikës 5, të nenit 20, si dhe pikës 8, të nenit 70, të ligjit nr. 155/2015, datë 21.12.2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, ministri i Financave

UDHËZON:

1. Ky udhëzim ka si qëllim përcaktimin e kushteve dhe standardeve minimale që duhet të plotësojnë pikat sekondare të ushtrimit të aktivitetit të shoqërive të licencuara në kategorinë e basteve të miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit.

2. Pikat sekondare të shoqërive të licencuara në kategorinë e basteve pas marrjes së miratimit me shkrim nga AMLF-ja për ushtrimin e aktivitetit duhet të plotësojnë kushtet dhe standardet minimale të mëposhtme:

a) tabela identifikuese e pikës sekondare duhet të përmbajë logon me emërtimin e shoqërisë së licencuar dhe/ose logon tregtare;

b) të afishohet në një vend të dukshëm të ambienteve të brendshme NUIS (numri unik i identifikimit të subjektit) origjinal i pikës sekondare, si dhe fotokopja e noterizuar e licencës për ushtrimin e aktivitetit në kategorinë e basteve;

c) të afishohet në një vend të dukshëm të ambientit të brendshëm të pikës sekondare në një format minimum A4, mbishkrim i cili përmban mesazhe për luajtjen e lojërave në mënyrë të përgjegjshme, rreziqet e mundshme të lojës së fatit, si dhe shanset reale për të fituar;

Mbishkrimi përmban dhe ndalimin për t'u futur apo për të luajtur në mjediset e pikave të basteve persona nën moshën 21 vjeç;

d) shoqëritë e licencuara në kategorinë e basteve sportive/ Administratori i Basteve Sportive është i detyruar të mbajë Regjistrin e Lojtarëve për çdo lojtar që do të marrë pjesë në baste për shumën e luajtura ose të fituara, që kalojnë vlerën 100 000 (njëqindmijë) lekë, si dhe të marrë e të ruajë të dhënat për identitetin e tyre për një afat jo më pak se 3 vjet nga momenti i regjistrimit të tyre;

e) në hyrje të pikës sekondare të ushtrimit të aktivitetit, të afishohet orari i ushtrimit të këtij aktiviteti në përputhje me orarin e përcaktuar në rregulloren e lojës të miratuar;

f) shoqëritë e licencuara në kategorinë e basteve sportive duhet të mbajnë në pikën ku ushtrojnë veprimtarinë një kopje të dokumentacionit, të cilin e ka depozituar pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit për miratimin e hapjes së pikës sekondare sipas parashikimeve të udhëzimit për përcaktimin e procedurave të hapjes dhe të mbylljes së adresave sekondare të basteve sportive.

g) shoqëritë e licencuara në kategorinë e basteve sportive kanë detyrimin të mbajnë vetëm kompjuterin ku është i instaluar program i lojës në sallën ku ushtrohet aktiviteti, përveç rastit kur është marrë miratim nga AMLF-ja për pajisje të tjera në përputhje me parashikimet e ligjit “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”.

h) pikat e basteve duhet të respektojnë distancën nga institucionet fetare, institucionet e arsimit parauniversitar dhe institucionet e arsimit të lartë, sipas parashikimeve të ligjit “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimit të ministrit të Financave “Për mënyrën e përlllogaritjes së distancave të subjekteve të lojërave të fatit midis tyre dhe nga institucionet fetare dhe arsimore”.

3. Kërkesat e përcaktuara në pikën 2 të këtij udhëzimi përbëjnë kushte dhe standarde minimale që duhet të plotësojnë pikat e basteve dhe nuk përjashtojnë asnjë nga kushtet/detyrimet e tjera parashikuara në ligjin

e lojërave të fatit sipas kategorive përkatëse të basteve.

Ngarkohet Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit dhe shoqëritë e licencuara në kategorinë e basteve për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Arben Ahmetaj